



02Nr. 1698 /2024
01.03.2024

Në bazë të Ligjit për Zyrtarët Publikë Nr.08/L-197 neni 80 dhe 81 , Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës Nr.03/L-068 neni 5 pika c, Ligjit të Punës Nr.03/L-212 neni 8 Udhëzimin Administrativ(MPMS) Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik,Udhëzimit Administrativ të MASHT-it Nr.05/2021, Për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, Komuna Hani i Elezit shpallë:

KONKURS

(Për plotësimin e vendit të punës me kohë të pacaktuar)

Institucioni: **Komuna Hani i Elezit**

Drejtoria: **Drejtoria për Arsim**

1.Titulli i vendit të punës: **Eduktor/e çerdhja e fëmijëve 0-3 vjeç
njësia/ sektori: Institucioni Parashkollor “Ardhmëria”**

Numri i pozitave: **Një (1) pozitë me afat të pacaktuar**

Koeficienti/Grada: **E21-5.1**

Orët e punës: **40 orë në javë**

Detyrat dhe përgjegjësitë për Eduktor/e :

- Është përgjegjëse për sigurimin e kualitetit të lartë të kujdesit dhe edukimit parashkollor përmes punës së drejtpërdrejt të saj me fëmijët në grupin e saj.
- Përgjegjës për zhvillim të përgjithshëm dhe përkujdesjes për fëmijët sipas standardeve të përcaktuara për edukim parashkollor.
- Zbatimi i planifikimit vjetor, mujor, javor dhe reflektimit ditor të aktiviteteve sipas grup moshave të fëmijëve
- Raportimi i çfardo shqetësimi për zhvillimin apo shëndetin e cilit do fëmijë individualisht drejtorit të kopshtit.
- Ndërtimi i raporteve dhe komunikimi profesional miqësor dhe bashkëpunues me prindër,kolegë dhe bashkëpunëtorët e jashtëm.
- Organizimi i takimeve individuale dhe grupore me prindër në nivel grupi.
- Kujdes fizik dhe emocional ndaj fëmijëve;
- Të kryejë edhe detyra të tjera të caktuara nga drejtor/e i IP -së.

Kushtet e përgjithshme në rekrutim:

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës.
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
- Të zotëroj të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët.
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse.
- Të mos jetë e/i denuar për kryerjen e veprës penale me dashje.
- Të mos ketë fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik.

Kualifikimi për Edukator/e

- Fakulteti i Edukimit-programi katërvjeçar i nivelit baçelor për edukimin në fëmijërinë e hershme 0-3 vjeç
- Shkolla e Mesme e Mjekësisë- drejtimi infermiere edukatore;
- Shkolla e Mesme e Mjekësisë-drejtimi i pediatriisë;
- Shkolla e Mesme e Mjekësisë-drejtimi –mami;
- Shkolla e Mesme e Mjekësisë së përgjithshme;

Dokumentet e nevojshme:

- Formulari i aplikimit (merret në Komunë – Qendra për Shërbime me Qytetarë)
- Rezumeja personale (CV).
- Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë kopje).
- Diploma e kualifikimit (ose certifikata) duhet të jene kopje të vërtetuara.
- Certifikata që nuk jeni nën hetime (nga gjykata)
- Dëshmi të përvojës në institucione arsimore (nëse ka).

Afati dhe mënyra e aplikimit:

Pranimi i aplikacioneve bëhet mbrenda tridhjetë (30) ditëve nga data 01.03.2024 deri 30.03.2024 nga ora 08:00-16:00

Të gjithë kandidatët e interesuar aplikacionin e punësimit mund ti marrin në formë fizike pranë Qendrës për Shërbime me Qytetarë në Han të Elezit kati i parë dhe të plotësuar e dorëzojnë në të njëjtin vend, apo ti shkarkojnë në portalin shtetëror <https://konkursi.rks-gov.net>

Dokumentacioni i kandidatëve të cilët nuk i plotësojnë kriterete konkursit nuk do të shqyrtohen ndërsa në faza tjera do të ftohen vetëm kandidatët që i plotësojnë kriteret e që futen në listë të ngushtë.

Të gjithë kandidatët të cilët kanë mbaruar studimet, jashtë Shtetit të Republikës së Kosovës, e që konkurrojnë për këto pozita, duhet që diplomat e tyre (gradat universitare të fituara) të jenë të njohura (nostrifikuara) nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në pajtim me Udhëzimin Administrativ, nr.12/2018 të datës 10.09.2018, në të kundërtën komisioni gjatë selektimit të aplikacioneve, do të refuzoj çdo aplikacion të kandidatëve të cilët nuk e kanë plotësuar këtë kusht të konkursit.

Mirë priten aplikacionet e femrave dhe meshkujve të të gjitha komuniteteve të Republikës së Kosovës

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Konkursi dhe rezultatet shpallen në linkun: <https://konkursi.rks-gov.net/>, në web faqen e komunës <https://kk.rks-gov.net/haniiielezit> dhe në tabelën e shpalljes.

